



**BASHKIA MIRDITË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3467/1 Prot

Rrëshen më, 30 . 09 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 72 datë 25. 09. 2024**

**PËR**

**“NJË NDRYSHIM NË VKB -TË NR. 61 & 62, DATË 26. 07. 2024, “PËR MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESAT E Z. ILIR HASHIM UKAJ, QYTETI RRËSHEN DHE Z. GJON MARK BUNAJ, FSHATI PROSEK”, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrotjen civile”, VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin nr.1, datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 50, datë 15.12.2023, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 61 dhe 62, datë 26.07.2024, “Për miratimin e dëmeve të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e familjes së Z. Ilir Hashim UKAJ, qyteti Rrëshen, njësia administrative Rrëshen dhe Z. Gjon Mark BUNAJ, fshati Prosek, njësia administrative Kthellë, bashkia Mirditë, me propozim të kryetarit të bashkisë dhe shqyrtimin e projektit në mbledhjen e datës 23.09.2024, të Komisionit Ekonomisë, Fianacave dhe Buxhetit, pas diskutimeve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 2, të secilit vendim 61 & 62, datë 26.07.2024, ku togfjalëshi “me fondet e veta” të zëvendësohet me togfjalëshin “nga fondet e mbrojtjes civile”, fond i kushtëzuar, i akorduar nga Ministria e Brendshme.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



ADRESA SHKESHË "ABAT DOÇI", RRËSHEN

tel dhe fax: (00355) (0) 2162233

**KRYETAR**

**Aleksandër PICAË**

www.bashkiamirdite.gov.al



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË**

Nr. 3467 Prot

Datë 13.09 /2024

**P/V E N D I M**

Nr. 82 date 13.09.2024

**“PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR.61 DHE 62, DATE.26.07.2024 PER MIRATIMIN E DEMEVE TE SHKAKTUARA NGA RENIA E ZJARRIT NE BANESAT E Z.ILIR HASHIM UKAJ DHE GJON MARK BUNAJ, NJESIA ADMINISTRATIVE RRESHEN. BASHKIA MIRDITE”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjin nr.97/2023, "Per buxhetin e vitit 2024", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit plotesues të MFE nr.1, datë.24.01.2024 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024", VKB nr.50 datë 15.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", në vkb nr.61 dhe 62, date.26.07.2024, "Per miratimin e demeve te shkaktuara nga renia e zjarrit ne banesat e z.Illir Hashim Ukaj dhe Gjon Mark Bunaj, njesia administrative Rreshen . Bashkia Mirdite”

**V E N D O S I:**

1. Të beje ndryshimin e pikes 2, te secilit vendim 61 dhe 62, ku tok-fjaleshi "nga fondet e veta", te zevendesohet me tok-fjaleshin "nga fondet e mbrojtjes civile", fond i kushtezuar dhe i akurduar nga **MB**.
- 2.. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise .
- 3.. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Gaspër TOPOLLAJ**

**Aleksander PICAKU**

Dr.Juridike, prok, protokoll: B. Deda

Dr. AIKE: F.Vorfi

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat: V.Gjoka

**Paraqiten projektin**

**KRYETARI**  
**Albert MËLYSHI**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov







G. Topolli

## BASHKIA MIRDITË

### DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE

Nr 3907 Prot.

Rrëshen me 15.10 2024

#### RELACION

#### MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË MBROJTJES CIVILE

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në ligjin Nr.68/2017 “Për financ e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në ligjin nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024” udhëzimit Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në udhëzimin nr. 1 dt.24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit 2024” ,në shkresën e MB nr.446/2 datë 20.02.2024 “ Mbi fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” në VKB nr.61,62 datë 30.07.2024 “Për miratimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit” si dhe në relacionin e Drejtorise AIKE të Bashkisë ju sqarojmë si më poshtë:

Me VKB Nr.61,62 dt.30.07.2024 dhe konfirmim Prefekti nr.634/5, 634/6 prot, dt.01.08.2024 janë miratuar vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z.Illir Hashim Ukaj qyteti Rrëshen ,Njësia Administrative Rrëshen dhe Z.Gjon Mark Bunaj fshati Prosek Njësia Administrative Kthellë. Në këto vendime në pikën 2 të tyre është përcaktuar që Bashkia Mirditë nga fondet e veta akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit. Meqenëse Bashkia ka në dispozicion fonde të mbrojtjes civile sipas shkresës së MB nr.446/2 datë 20.02.2024 kërkojmë që këto vendime të përballohen nga fondet e mbrojtjes civile.

Për këtë arsye në vendimet e mësipërme në pikën 2 të tyre kërkojmë që të bëhet ndryshimi i tog-fjalëshit “ **nga fondet e veta**” të zëvendësohet me tog-fjalëshin “ **me fondet e mbrojtjes civile**” fond i kushtëzuar dhe i akorduar nga MB. Fondet e kushtëzuara nuk trashëgohen nga Bashkia dhe për këtë arsye kërkojmë që të përdoren për likuidimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri sipas VKB të mësipërme.

Konc: Vjollca Gjoka

MIRATOI

KRYETARI

Albert MËLYSHI

